



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR VLORË-HIMARË
SEKTORI I MONITORIMIT TË KURRIKULËS DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL

Nr. 3041 Prot.

Vlorë, më 15 . 12 . 2025

NJOFTIM

Të gjithë praktikantët, të cilët kanë përfunduar me sukses praktikën profesionale në periudhën e parë mësimore, shtator – dhjetor 2025, janë të lutur të dorëzojnë pranë ZVAP Vlorë-Himarë portofolin e praktikantit, i cili duhet të përmbajë:

1. Planin lëndor vjetor
2. Planin e periudhave për lëndën përkatëse
3. Plane ditore të orëve mësimore (2-3 modele)
4. Teste të kapitujve ose periudhës (2-3 modele)
5. Projektin kurrikular të nxënësit (1-2 modele)
6. 2-3 shembuj të përdorimit nga praktikanti të burimeve të mësimdhënies, përveç tekstit të nxënësit, veçanërisht të përdorimit të TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësit;
7. 3-4 shembuj të metodave që ka përdorur praktikanti, për të formuar te nxënësit aftësitë e :
 - a) Komunikimit me gojë dhe me shkrim
 - b) Të menduarit kritik
 - c) Të menduarit krijues
 - d) Të punuarit në grup
 - e) Të gjithëpërfshirjes
 - f) Të menaxhimit nga nxënësit me vështirësi në të nxënë
 - g) Të punës me nxënësit me vështirësi në të nxënë
 - h) Të punës me nxënësit me prirje të veçanta
8. Raportin e praktikantit me reflektime mbi përvojat e tij gjatë praktikës profesionale, me sukseset më të spikatura dhe vështirësitë kryesore, sipas shtojcës nr.6, “Raporti i praktikantit”, bashkëlidhur urdhërit nr.100, datë 25.02.2022, i ndryshuar.

Afati i dorëzimit të portofolit të praktikantit është nga data 22.12.2025-29.12.2025, ora 16:30.



Adresa: Lagjia “28 Nëntori”, Rruga: “Siko Nako”, Vlorë. e-mail: ZVAVlore@arsimi.gov.al